

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE,
TETOR 2003¹**

Tiranë 2003

¹ Raporti është bazuar në vëzhgimet e kryera nga vëzhguesit e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, 12 tetor 2003. Vëzhgimet u mundësuan me mbështetjen financiare të sektorit të çështjeve publike, Komisioni për demokraci, pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

PËRMBAJTJA

Dy fjalë për Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe misionin e tij

- 1 Zgjedhjet e 12 tetorit 2003 dhe situata politike në Shqipëri
 - 2 Korniza ligjore
 - 3 Përbërja e KQZ-ve, KZQV-ve dhe KQV-ve dhe Kolegji Zgjedhor
 - 4 Procesi i regjistrimit të kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore dhe problemet e dala nga vëzhgimet e KSHH-së
 - 5 Listat paraprake të zgjedhësve, rishikimi i tyre dhe problemet e dala nga vëzhgimet e KSHH-së
 - 6 Disa çështje lidhur me fushatën zgjedhore dhe median
 - 7 Procesi i votimit
 - 8 Çështje të tjera
 - 9 Përfundime dhe sugjerime lidhur me përmirësimin e Kodit zgjedhor dhe ecurinë e procesit zgjedhor, tetor 2003
-

Shtojcë nr. 1

Për veprimtarinë e KSHH-së në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të tetorit 2003

Shtojcë nr. 2

Deklaratat e KSHH-së gjatë procesit zgjedhor, tetor 2003

Shtojcë nr. 3

Komunikimi zyrtar mes KSHH-së dhe KQZ-së

Shtojcë nr. 4

10 Shkurtesa

DY FJALË PËR KOMITETIN SHQIPTAR TË HELSINKIT DHE MISIONIN E TIJ

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) është e para organizatë joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ai u themelua më 19 dhjetor të 1990-s, si Forumi i të Drejtave të Njeriut dhe fill pas kësaj u regjistrua në Ministrinë e Drejtësisë, me vendimin nr. 17/1, datë 12.I.1991. Më vonë, në përputhje me ligjin, ky Komitet u regjistrua në gjykatën e rrethit Tiranë. Qëllimi i organizatës është vëzhgimi, sensibilizimi dhe edukimi i publikut për një respektim më të mirë të të drejtave dhe lirive themelore të individit në vend.

Në mars të vitit 1992, Federata Ndërkombëtare e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut e njohu dhe e pranoi këtë organizatësi anëtare e saj, duke marrë emrin që ka sot.

Misioni i Komitetit Shqiptar të Helsinkit është:

1. *Të vëzhgojë* respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fusha të ndryshme.
2. *Të sensibilizojë dhe të edukojë* opinionin publik për të drejtat politike, shoqërore, civile dhe kulturore, për mbrojtjen e tyre dhe për procedurat që duhen të ndiqen në rast se këto të drejta dhunohen.
3. *Të reagojë* kundrejt shkeljeve të akteve ligjore të brendshme dhe ndërkombëtare që i përkasin kësaj sferë, nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj elektronike, kontakteve të drejtpërdrejta ose raporteve drejtuar autoriteteve përkatëse për të vënë në vend të drejtat e dhunuara.
4. *Të rekomandojë* përmirësime në kuadrin ligjor dhe në praktikat e punës në fushën e të drejtave të njeriut, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe standardeve ndërkombëtare.
5. *T'u rekomandojë* institucioneve shtetërore të respektojnë ose të përmirësojnë gjendjen e të drejtave të njeriut.
6. *Të botojë* raporte për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri; informacione në formë fletëpalosjesh, kartash ligjore, broshurash, guidash etj.; buletine dhe raporte tremujore.
7. *Të mirëmbajë* një databazë me materiale ligjore për të drejtat e njeriut si dhe të dhëna për shkeljet e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe në fusha të veçanta.

Bazuar në misionin që ka, KSHH-ja zotëron një metodologji të kualifikuar në punën e tij. Vëzhgimet, rezultatet e të cilave janë bërë publike dhe kanë ndikuar pozitivisht në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, përbëjnë thelbin e punës së kësaj organizate. Krahas vëzhgimeve, KSHH-ja sinjalizon organet përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të njeriut që ky komitet konstaton dhe u rekomandon përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme shtetërore të marrin masat përkatëse për të rivendosur të drejtat e shkelura.

Pjesë e punës së tij janë, gjithashtu, veprimtaritë për përmirësimin e praktikave të respektimit të të drejtave të njeriut (letra drejtuar institucioneve shtetërore, rekomandime, opionenca, shkëmbim informacioni etj.), veprimtaritë ndërgjegjëse dhe sensibilizuese të publikut (seminare, tryeza të rrumbullakëta,

fushata sensibilizuese, reagime publike në median e shkruar dhe elektronike), ndihmesa për forcimin e një mjedisi sa më ligjor nëpërmjet oponencave, tryezave të ekspertëve, trajnimeve të ofruara, informimit më të mirë të publikut me metoda të tilla, si: seminare, përdorimi i medias, publikime të ndryshme, takime dhe kontakte me njerëzit dhe trajtimi i letrave dhe ankesave, si dhe asistencë ligjore për ligjet dhe mbrojtjen që ato afrojnë për ta.

1

ZGJEDHJET E 12 TETORIT 2003 DHE SITUATA POLITIKE NË SHQIPËRI

Zgjedhjet e 12 tetorit 2003 ishin zgjedhje për organet e qeverisjes vendore, për të zgjedhur kryetarët e bashkive dhe këshilltarët në 65 bashki, 11 njësi bashkiake të Tiranës dhe 308 komuna në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ato ishin të katërtat në radhë fill pas 1991-së.

Këto zgjedhje u zhvilluan në një kohë kur situata politike ishte pak a shumë e ekuilibruar, si pasojë e një fryme konsensusi mes dy partive të mëdha, të pozitës dhe të opozitës. Kjo periudhë e konsensusit politik, që u vu re me zgjedhjen konsensuale të presidentit të Republikës, në qershor të 2002-së, shënoi përmirësime në jetën politike të vendit.

Në janar të vitit 2003, BE-ja hapi negociatat për asociim-stabilizim me Shqipërinë dhe qeveria shqiptare, duke iu përmbajtur kësaj marrëveshjeje, erdhi me një strategji për reforma institucionale në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si edhe në lidhje me decentralizimin e qeverisjes vendore.

Gjatë periudhës maj-prill 2003 u ngrit dhe zhvilloi veprimtarinë e tij komisioni bi-partizan. Ky komision, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë të OSBE-së, punoi për të përmirësuar Kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, duke iu referuar rekomandimeve të paraqitura në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e vitit 2001.

Nga korriku 2003, dy partitë e mëdha të pozitës dhe të opozitës filluan bisedimet me partitë e vogla të spektrit të tyre me qëllim që të krijonin aleanca me to për zgjedhjet e qeverisjes vendore. Si rezultat i këtyre bisedimeve u krijuan disa marrëveshje për të dalë me kandidatë të përbashkët në disa nivele të qeverisjes vendore, ndërkohë që pothuajse shumica e partive të spektrit të majtë dhe të djathtë deklaruan se do të dilnin të pavarura në këto zgjedhje.

2

KORNIZA LIGJORE

Zgjedhjet e 12 tetorit 2003, për organet e qeverisjes vendore, u zhvilluan sipas Kodit të ri zgjedhor, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më 19 qershor 2003. Siç është përmendur edhe në hyrjen e këtij raporti, amendamentet që iu bënë Kodit të vjetër zgjedhor kishin për qëllim përmirësimin e këtij të fundit duke iu referuar rekomandimeve të paraqitura në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e vitit 2001. Këto amendamente u pranuan me konsensus nga komisioni bipartizan. Kodi i ri zgjedhor gjeti mbështetjen e plotë të të dyja partive të mëdha, PS dhe PD.

Me gjithë qëllimin e mirë për të përmirësuar aspekte të ndryshme të Kodit të vjetër zgjedhor, KSHH-ja, në analizat që i ka bërë Kodit të ri zgjedhor, ka vënë në pah një sërë problemesh dhe mangësish, të cilat i ka bërë publike në disa letra zyrtare drejtuar KQZ-së¹.

Në këtë pjesë të raportit ne do të ndalemi vetëm në ato ndryshime që KSHH-ja i konsideron pozitive në Kodin e ri zgjedhor, si:

1. Kodi zgjedhor (neni 51) ka parashikuar organet që hartojnë listat e zgjedhësve, që janë zyrat e gjendjes civile. Sipas kësaj dispozite: “Rishikimet e mundshme në listën e zgjedhësve bëhen vetëm nga organet që hartojnë dhe miratojnë listën e zgjedhësve”.
2. Forcat që nuk mund të përdoren gjatë periudhës zgjedhore janë: forcat komando, forcat e tjera të ushtrisë dhe punonjësit e strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror, të cilat përcaktohen në nenin 116 të KZ.
3. Kodi zgjedhor (nenet 136-140) përcakton në mënyrë të detajuar detyrat e radiotelevizionit publik dhe privat, të cilat kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore, kriteret që duhen përdorur etj. Ngritja e Bordit të Monitorimit të Medias, sipas nenit 142 të këtij Kodi, ishte, gjithashtu, një zhvillim pozitiv. Ky Bord monitoroi zbatimin e dispozitave të lartpërmendura në lidhje me detyrat e radiotelevizionit publik dhe privat gjatë fushatës zgjedhore.
4. Lidhur me ankimin në rrugë gjyqësore, KSHH-ja vlerëson si të drejtë miratimin e dispozitave që u japin kompetencë gjykatave të rretheve vetëm në shqyrtimin e ankesave lidhur me ndryshimet në listat e zgjedhësve dhe vendimet e tyre, sipas Kodit zgjedhor, janë të formës së prerë.

¹ Për më tepër informacion lidhur me problemet dhe mangësitë e Kodit të ri zgjedhor, ju lutem lexoni në pjesën “Përfundime dhe sugjerime lidhur me përmirësimin e Kodit zgjedhor dhe ecurinë e procesit zgjedhor, tetor 2003” në këtë raport.

5. KSHH-ja vlerëson krijimin e një kolegji zgjedhor të gjykatës së apelit të Tiranës² dhe kompetencat e tija të përcaktuara në Kodin zgjedhor, në lidhje me vendimet e kësaj gjykate, të cilat janë të formës së prerë.
6. KSHH-ja vlerëson si hap përpara drejt përmirësimit të legjislacionit zgjedhor rregullimin nga Kodi zgjedhor të ankimit në rrugë administrative të vendimeve të komisioneve zgjedhore (nenet 146-161). Në këtë mënyrë disiplinohet shqyrtimi i çështjeve, garantohet shqyrtimi i gjithanshëm dhe objektiv i tyre, procesi zgjedhor bëhet më transparent etj.
7. KSHH-ja është e mendimit se pjesa e trembëdhjetë e Kodit zgjedhor, ku bëhet fjalë për përgjegjësitë dhe sanksionet, jo vetëm është e qartë dhe më e detajuar, por përcakton edhe kriteret për dënimin me gjobë.
8. KSHH-ja vlerëson si hap pozitiv në Kodin e ri zgjedhor edhe çështje të tilla, si: subjektet e parimit të moscenimit të zgjedhjeve (neni 4 i këtij kodi); ndalimin e përdorimit të burimeve në mbështetje të kandidatëve, partive politike ose koalicioneve (neni 5) si edhe emërimin dhe detyrat e nëpunësit ndërlidhës (neni 6), pavarësisht se në këto dispozita ka edhe ndonjë paqartësi.

Duke folur për ndryshimet e bazës ligjore, nuk mund të lëmë pa përmendur se, më 1 tetor 2003, Këshilli i Ministrave nxori një akt normativ, i cili i bëri ndryshime ligjit "Për Policinë e Shtetit", duke zgjeruar grupin e forcave të policisë që do të përdreshin një ditë përpara zgjedhjeve, gjatë ditës së votimit dhe pas mbylljes së qendrave të votimit.

² Vërejtjet për këtë çështje do t'i gjeni në pjesën "Përfundime dhe sugjerime lidhur me përmirësimin e Kodit zgjedhor dhe ecurinë e procesit zgjedhor, tetor 2003" në këtë raport.

3

PËRBËRJA E KQZ-SË, KZQV-VE, KQV-VE DHE KOLEGJI ZGJEDHOR

Administrata zgjedhore përbëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 385 komisione zgjedhore të qeverisjes vendore (KZQV), në çdo bashki dhe komunë dhe 4688 komisione të qendrave të votimit (KQV) në çdo qendër votimi.

Për sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së, Kodi zgjedhor, në nenin 22, pikat 1,2, dhe 3 të tija, përcakton formulën se dy anëtarë të këtij Komisioni zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë në bazë të propozimeve përkatëse të spektrit të majtë dhe të djathtë të përbërjes politike të tij, duke përjashtuar dy partitë më të mëdha të secilit spektër politik. Presidenti i Republikës emëron dy anëtarë të KQZ-së në bazë të propozimeve përkatëse të dy partive më të mëdha të pozitës dhe të opozitës. Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh tre anëtarë të KQZ-së me një shumicë prej 2/3 e votave. Në rast se nuk arrihet shumica e nevojshme, bëhet një votim i dytë ndërmjet kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e parë. Megjithatë vetëm 3 anëtarë të Komisionit janë zgjedhur sipas Kodit të ri zgjedhor. Anëtarët e tjerë kanë mandatin sipas legjislacionit të vjetër. Njëri nga anëtarët e rinj u caktua nga presidenti i Republikës dhe një anëtar tjetër nga Parlamenti. Anëtari i tretë i KQZ-së u zgjodh nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD). Zgjedhja e anëtarit nga KLD-ja u përball me shumë debate dhe kundërshtime të partive të spektrit të djathtë, sidomos të PD-së. Kjo e fundit pretendonte se është prishur marrëveshja politike midis PS-së dhe PD-së për anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve, është prishur baraspesha e përfaqësimit politik në KQZ. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, duke respektuar mandatin e tij të një organizate vëzhguese të pavarur, nuk mori pjesë në interpretimet politike të këtij debati, megjithatë ai është i mendimit se në zgjedhjen e anëtarit të tretë të KQZ-së, KLD-ja zbatoi nenin 22 dhe 20 të Kodit zgjedhor.

Të gjitha partitë politike kanë të drejtë të kenë një përfaqësues pa të drejtë vote në mbledhjet e KQZ-së. Të pranishëm mund të jenë, gjithashtu, edhe vëzhgues vendës si dhe media.

Për sa i përket përbërjes së KZQV-ve dhe KQV-ve, ato përbëhen nga 7 anëtarë të caktuar sipas formulës së përcaktuar në Kodin e ri zgjedhor, i cili kërkon baraspeshë politike (neni 40/1, germa a dhe b të Kodit zgjedhor). Për sa i përket KZQV-ve, dy vende u jepen dy partive më të mëdha, PS-së dhe PD-së, një vend i tretë, në gjysmën e KZQV-ve të Shqipërisë, i rezervohet PS-së dhe, në gjysmën tjetër, PD-së. Vendet e mbetura u shpërndahen partive të tjera, bazuar në rezultatet e mbledhura në rang kombëtar nga zgjedhjet vendore të vitit 2000. Sipas nenit 45 të Kodit zgjedhor, e njëjta formulë zbatohet edhe për krijimin e KQV-ve. Partitë, koalicionet dhe kandidatët që marrin pjesë në garë për zgjedhjet dhe që nuk kanë anëtarë në KZQV dhe KQV, sipas nenit 41 dhe 45/7 të Kodit zgjedhor, mund të caktojnë përfaqësues pa të drejtë vote. Nenet 40/2 dhe 45/2 të Kodit zgjedhor përcaktojnë se sekretarët e këtyre komisioneve duhet të jenë juristë.

KSHH-ja e konsideron pozitive që në Kodin e ri zgjedhor parashikohet ngritja e një kolegji zgjedhor të gjykatës së apelit, që shqyrton ankesat kundër vendimeve të KQZ-së. Vendimet e kësaj gjykate janë të formës së prerë.

FUNKSIONIMI I KQZ-SË GJATË PROCESIT ZGJEDHOR PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është i mendimit se, në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, KQZ-ja ka punuar në përgjithësi mirë në administrimin e zgjedhjeve. Në këtë drejtim janë mbajtur parasysh edhe disa vërejtje që i janë bërë këtij Komisioni në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it të vitit 2001, madje ato kanë gjetur pasqyrim dhe në formulimin e disa dispozitave të Kodit të ri zgjedhor, siç janë, p.sh., neni 29 (kompetencat e KQZ-së), neni 30 (mbledhjet dhe vendimmarrja e KQZ-së), neni 31 (aktet e KQZ-së dhe hyrja në fuqi e tyre) si dhe kreu 12 të "Ankimimet", ku bëhet fjalë për procedurën e shqyrtimit të çështjeve nga KQZ-ja etj.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ky organ ka demonstruar përgjithësisht profesionalizëm, transparencë dhe objektivitet, megjithatë ka pasur edhe ndonjë rast ngurrimi nga ana e KQZ-së. Ndryshime të dukshme ka pasur në organizimin më të mirë të ndjekjes dhe të kontrollit të çështjeve të caktuara në drejtim të transparencës së mbledhjeve të planifikuara, në nxjerrjen e udhëzimeve. Edhe në caktimin e afateve për paraqitjen e propozimeve për anëtarë të KZQV-ve dhe të KQV-ve nga partitë politike, KQZ-ja ka vepruar drejt, por e keqja është se në mjaft raste këto afate janë shkelur. Si rrjedhojë, KZQV-të dhe KQV-të pjesërisht, jo vetëm nuk janë ngritur në afatet e përcaktuara në ligj, por kjo ka krijuar edhe vështirësi në trajnimin e anëtarëve të tyre, me gjithë ndërhyrjet e shpeshta të KQZ-së.

KSHH-ja konsideron pozitive edhe zbatimin nga KQZ-ja të programit për edukimin zgjedhor të shtetasve, gjë që ka qenë me mangësi të theksuara në të kaluarën. Sensibilizimi dhe edukimi zgjedhor ka qenë i ndjeshëm, si në radiotelevizionin publik dhe privat, në median e shkruar dhe elektronike, nëpërmjet aksesit të internetit si edhe nëpërmjet telefonit falas, vënë në dispozicion të qytetarëve. Ky proces sensibilizimi filloi kohë më parë dhe nuk është lënë kryesisht 2-3 ditë para zgjedhjeve (siç ka ndodhur në zgjedhjet e mëparshme) dhe se kjo fushatë mbuloi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor.

KSHH-ja ka mendimin se disa herë veprimtaria e KQZ-së është penguar nga ndërhyrjet vend e pa vend të përfaqësuesve të partive politike pa të drejtë vote në këtë komision. Presioni politik mbi këtë organ ka qenë i pranishëm gjatë gjithë procesit zgjedhor, por u bë më i dukshëm sidomos në procesin paszgjedhor, pikërisht kur KQZ-ja do të bënte shpalljen me vendim të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi, në bazë të rezultateve të shpallura nga KZQV-të përkatëse³.

UDHËZIMET E KQZ-SË DHE SUGJERIMET E KSHH-SË NË LIDHJE ME TO

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka studiuar me vëmendje të gjitha udhëzimet e KQZ-së për zgjedhjet dhe i konsideron ato kontribut të çmuar për një kuptim dhe zbatim të drejtë të ligjit. Lidhur me këto udhëzime, veç vlerësimeve, KSHH-ja i ka parashtruar KQZ-së edhe ndonjë vërejtje apo sugjerim, si më poshtë:

³ Në lidhje me këtë argument, KSHH-ja ka mendimin se KZQV-të kanë përgjegjësi për shpalljen me vonesë të rezultateve të zgjedhjeve, sidomos në Tiranë, dhe se, në këto rrethana, KQZ-ja, në përputhje me ligjin, mund të ndërhynte në mënyrë më efektive për parandalimin e kësaj zvarritjeje të theksuar dhe me pasoja.

- a) Në udhëzimin nr.7, datë 13.IX.2003, thuhet se anëtarët e KQV-ve nuk mund të jenë persona që, për shkak të detyrës, janë të pajisur me armë. Në të vërtetë kjo është një normë e re që nuk mund të rregullohet me udhëzim, sepse neni 458 i Kodit zgjedhor nuk e parashikon këtë kriter.
- b) Në udhëzimin nr. 7, datë 13.IX.2003, thuhet se partisë politike që ka propozuar zv/kryetarin në KQV-të e bashkisë/komunës përkatëse, i lind e drejta të bëjë edhe propozimin e sekretarit për çdo qendër votimi të kësaj bashkie/komune. Me këtë rast, ne kemi shfaqur mendimin se këtë të drejtë nuk mund ta kishte asnjë parti politike, jo vetëm se këtë nuk e thotë ligji, por edhe për faktin se sekretari ka statusin e anëtarit pa të drejtë vote dhe ai ka vetëm funksione administrative.
- c) Për udhëzimin nr.8, datë 15.IX.2003, "Për procedurat ankimore administrative...", kemi shfaqur mendimin se në mjaft pika të këtij udhëzimi është përsëritur ligji. Sipas pikëpamjes sonë, udhëzimi nxirret për kuptimin dhe zbatimin më të mirë të ligjit.
- d) Në udhëzimin nr. 5, datë 03.IX.2003, ku bëhet fjalë për procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve, jemi shprehur kundër asaj pjese të këtij udhëzimi ku thuhet: "Në rast se nuk ka kërkesë personale të zgjedhësit për të ndryshuar qendrën e votimit, KZQV-ja ia dërgon zyrës së gjendjes civile përkatëse të dhënat e zgjedhësve për të përcaktuar vendbanimin e zgjedhësve". Kjo bie ndesh me pikën 3, neni 58 i Kodit zgjedhor (shih dhe germën "dh", pika 1 e nenit 58), ku thuhet se kërkesat e partive politike, të subjekteve zgjedhore dhe të institucioneve të tjera të interesuara duhet të shoqërohen me kërkesën personale të zgjedhësve.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e ka sinjalizuar KQZ-në edhe për çështje të tjera duke u mbështetur në sinjalizimet apo në informacionet e vëzhguesve tanë gjatë procesit parazgjedhor si edhe gjatë ditës së votimit⁴.

ANKIMET

Edhe pse Komiteti Shqiptar i Helsinkit nuk e ka vëzhguar këtë proces, mund të themi se për herën e parë në Kodin zgjedhor janë përcaktuar procedura më të plota dhe më të qarta për shqyrtimin e ankesave. Sipas të dhënave të KQZ-së, numri i këtyre ankesave ka qenë relativisht i madh. Vëzhguesit tanë kanë asistuar në disa nga çështjet e shqyrtuara në KQZ dhe patën përshtypjen se procedurat e parashikuara në Kod respektoheshin në përgjithësi drejt. Megjithatë, nuk na është dukur normale ndërhyrja me vend dhe pa vend e përfaqësuesve të partive politike me replika dhe debate të acaruara.

Objekti i ankimeve në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor të gjykatës së apelit ka qenë i ndryshëm. Shumica dërrmuese e ankimeve në KQZ është pranuar për shqyrtim, ndërsa në fare pak raste, pala ankuese është tërhequr. Deri në datën 5.XI.2003, në gjykatën e apelit janë paraqitur 56 ankesa kundër vendimeve të KQZ-së.

Nga sa u tha më sipër, del se pavarësisht nga deklaratat politike dhe kritikrat që ky apo ai subjekt ka bërë në adresë të komisioneve zgjedhore, në këto zgjedhje ata kanë ndjekur në përgjithësi rrugën e ankimit të përcaktuar në Kodin zgjedhor, edhe pse ky apo ai subjekt nuk është pajtuar me vendimin që ka dhënë KQZ-ja apo Kolegji Zgjedhor i gjykatës së apelit.

⁴ Për më shumë informacion në lidhje me komunikimin zyrtar midis KSHH-së dhe KQZ-së, lutemi lexoni në aneks nr.3 në këtë raport.

KSHH-ja e konsideron zvarritje të pajustificueshme shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për bashkinë e Tiranës nga ana e komisioneve zgjedhore. Kemi mendimin se kjo zvarritje ka ardhur si pasojë e mosmarrëveshjeve të komisionerëve zgjedhorë, ndikimeve politike mbi komisionerët dhe nga moszbatimi me rigorozitet i Kodit zgjedhor.

KSHH-ja i ka kërkuar disa herë KQZ-së informacione të ndryshme për ankesat që ky i fundit ka marrë nga subjektet zgjedhore. Përfitojmë nga rasti të nënvizojmë faktin se KQZ-ja, në çdo rast, i ka dhënë informacione të plota, transparente dhe në kohë kërkesave zyrtare që KSHH-ja i ka dërguar këtij komisioni.

FUNKSIONIMI I KZQV-VE DHE KQV-VE DHE PROBLEMET E KONSTATUARA NGA VËZHGUESIT E KSHH-SË

KSHH-ja vëzhgoi nga afër procesin e ngritjes së KQV-ve, funksionimin e KZQV-ve dhe KQV-ve, trajnimin e komisionerëve si edhe komunikimin midis vetë anëtarëve të këtyre komisioneve zgjedhore të qeverisjes vendore. KSHH-ja ka vënë re se ka pasur vonesa në ngritjen e KZQV-ve dhe KQV-ve. Shkaku është mosrespektimi i afateve ligjore të përcaktuara në Kodin zgjedhor, brenda të cilave partitë përkatëse politike duhet të bënin propozimet e tyre për anëtarë të këtyre komisioneve. Sipas njoftimit zyrtar të zëdhënësit të KQZ-së, deri më datën 2 tetor (afati ligjor i përcaktuar në Kodin zgjedhor për ngritjen e KQV-ve) ishin ngritur rreth 70 për qind të KQV-ve në shkallë vendi dhe vonesat për ngritjen e KQV-ve për pjesën e mbetur kishin ardhur si rrjedhojë e vonesave të propozimeve nga partitë politike.

Për sa i përket dokumentacionit të kandidatëve për anëtarë të KQV-ve, i depozituar nga subjektet politike në KZQV-të përkatëse, KSHH-ja ka vënë re se, në përgjithësi, ka pasur përpjekje nga komisionerët e KZQV-ve për të verifikuar dokumentacionin e kandidatëve për anëtarë të KQV-ve sipas kërkesave të Kodit zgjedhor (neni 45, pikat 2-6). Gjithashtu, vëzhguesit e KSHH-së kanë raportuar raste kur ka pasur mungesa në dokumentacion, si në disa njësi bashkiake në Tiranë dhe në rrethet ku KSHH-ja vëzhgoi nga afër këtë proces. Në disa raste ky dokumentacion ishte i përbërë vetëm nga një listë emërore e kandidatëve për anëtarë të KQV-ve, e pashoqëruar me dokumentacionin përkatës në përputhje me dispozitën e lartpërmendur. Anëtarët e KZQV-ve, të cilët ishin përgjegjës për shqyrtimin dhe plotësimin e këtij dokumentacioni, u mjaftuan vetëm me mirëbesimin e partive politike duke mos respektuar në këtë mënyrë disa nga kërkesat e nenit 45 të Kodit zgjedhor.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka arritur në përfundimin se partitë përkatëse politike që kanë të drejtën e propozimeve për anëtarë të KZQV-ve dhe të KQV-ve nuk i kanë kushtuar kujdesin e duhur përzgjedhjes cilësore të tyre. Kjo ka ndikuar negativisht në zbatimin rigoroz të Kodit zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së dhe që u reflektua në aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor.

Përbërja e KZQV-ve në përgjithësi ka qenë në përputhje me ligjin, por në disa zona të vëzhguara prej KSHH-së nuk janë respektuar kriteret për anëtarë të KZQV-ve, siç është, p.sh., kriteri që përcakton arsimin e anëtarëve të KZQV-së, të cilët duhet të jenë me arsim të lartë, dhe sekretari të jetë jurist.

Ngritja me vonesë e KZQV-ve dhe KQV-ve ka ndikuar negativisht edhe në vonesat në trajnimin e tyre. Sipas informacioneve të marra nga KQZ-ja, ky i fundit organizoi 4 trajnime intensive për anëtarët e KZQV-ve dhe një trajnim për anëtarët e KQV-ve vetëm dy ditë përpara zgjedhjeve të 12 tetorit 2003. Komiteti Shqiptar i Helsinkit i ka shprehur shqetësimin e tij KQZ-së për trajnimet e pakta në numër dhe kohën e paktë të vënë në dispozicion për këto trajnime sidomos për anëtarët e KQV-ve.

Një problem tjetër që vlen të përmendet në lidhje me komisionerët e KZQV-ve dhe KQV-ve ka qenë tërheqja e një numri të anëtarëve të KZQV-ve dhe të KQV-ve që duheshin zëvendësuar përkatësisht nga KQZ-ja dhe KZQV-të. Sipas deklaratës së KQZ-së, pas 12 tetorit 2003, partitë politike i kanë kërkuar KQZ-së 923 zëvendësime të anëtarëve të komisioneve vendore, duke sjellë në përbërje të këtyre komisioneve individë të cilët nuk iu nënshtruan trajnimit të duhur.

MARRËDHËNIET NDËRMJET ANËTARËVE TË KZQV-VE DHE KQV-VE GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Vëzhguesit e KSHH-së kanë informuar se në disa KZQV ka pasur mosmarrëveshje ndërmjet anëtarëve të komisionit nisur nga interesa të ngushtë partiakë ose sipas porosive të partive. Këto mosmarrëveshje u bënë më të mprehta në një pjesë të KZQV-ve, sidomos në procesin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën e tyre. Sipas nenit 110 të Kodit zgjedhor, jo më vonë se dy ditë pas ditës së zgjedhjeve, KZQV-ja, në prani të anëtarëve të komisionit, të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe të vëzhguesve të akredituar, shqiptarë dhe të huaj, shpall rezultatet e zgjedhjeve.

Disa nga këto KZQV parapëlqyen shfrytëzimin e së drejtës ligjore për të mos marrë vendime kur nuk votojnë pro pesë anëtarë, ndërsa disa të tjera, si për shembull KZQV-ja e Durrësit, edhe pse e shfrytëzoi këtë të drejtë, vonoi dërgimin e materialeve në KQZ (për kandidatin e Durrësit KQZ-ja vendosi në datën 20 tetor 2003).

KZQV-ja e Tiranës i ka dërguar materialet përkatëse në KQZ me shumë vonesë, vetëm në datën 23 tetor 2003. Nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike jemi informuar për atmosferën midis anëtarëve të këtij komisioni ku, si njëra dhe tjetra palë fajësojnë njëra-tjetrën me gjithë paralajmërimet e KQZ-së që të mos e bllokojnë procesin. Për këtë vlen të përmendet se komisioni zgjedhor, duke përfshirë këtu edhe KZQV-në, nuk duhet të bëjë deklaratë ose të japë intervista me elementë politiko-emocionalë, pa kryer detyrën që i ngarkon ligji.

Është për të ardhur keq që anëtarë të veçantë të KZQV-së së Tiranës vazhduan për një kohë të gjatë të bëjnë prononcime publike si kundërshtarë politikë dhe jo si anëtarë që zbatojnë dispozitat e Kodit zgjedhor dhe që duhet të vepronin në frymën e këtij Kodi. Në rastet kur çdo KZQV konstaton shkelje ligjore, si mungesa e materialeve përkatëse në kutitë e votimit, mungesa e dokumentacioni etj., duhet zbatuar neni 110 i Kodit zgjedhor. Kjo do të thotë që, në procesverbalin përkatës, të fiksohen dhe të shënohen të gjitha parregullsitë që konstatohen, të pasqyrohen kundërshtimet e këtij apo atij anëtari të KZQV-së ose të përfaqësuesve të pranishëm të forcave politike etj.

Të metat që kanë raportuar vëzhguesit tanë gjatë ditës së votimit dhe gjatë procesit të shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KZQV-të kanë të bëjnë jo vetëm me mosnjohjen e mirë të ligjit nga anëtarët e KQV-ve dhe të KZQV-ve, por edhe me ndikimin partiak mbi përfaqësuesit e partive politike në komisione.

4

PROCESI I REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE DHE PROBLEMET E DALA NGA VËZHIMET E KSHH-SË

Sipas nenit 78 të Kodit zgjedhor, dokumentacioni për paraqitjen e kandidatëve për kryetar bashkie ose komune, apo për këshillin e bashkisë ose të komunës, dorëzohet në KZQV jo më vonë se 32 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Komisionet përkatëse verifikojnë saktësinë e dokumentacionit të paraqitur jo më vonë se 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Nga vëzhgimet e kryera nga vëzhguesit e KSHH-së ka rezultuar se regjistrimi i kandidatëve për kryetar bashkie ose komune, apo për këshillin e bashkisë ose të komunës në përgjithësi është bërë brenda afatit ligjor.

Në disa zona të vëzhguara, ka pasur raste kur ky dokumentacion nuk ka qenë i rregullt ose ka qenë i paplotësuar, për këtë arsye është kthyer për plotësim nga KQZV-të tek kandidatët përkatës. Është raportuar edhe një rast kur i njëjti kandidat për këshilltar është paraqitur nga dy subjekte zgjedhore, si p.sh., në Fier, por më vonë është rregulluar.

Vëzhguesit e KSHH-së, me përjashtim të rastit të tërheqjes së një kandidati të PDR-së në Elbasan, nuk kanë raportuar asnjë rast tjetër tërheqjeje nga ana e kandidatëve për kryetar bashkie ose komune, apo për këshillin e bashkisë ose të komunës në zonat ku ata kanë vëzhguar.

5

LISTAT PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE, RISHIKIMI I TYRE DHE PROBLEMET E DALA NGA VËZHGIMET E KSHH-së

KODI ZGJEDHOR PËR LISTAT E ZGJEDHËSVE

Listat e zgjedhësve janë dokumente zyrtare të regjistrimit të zgjedhësve për çdo zonë të qendrës së votimit, në përputhje me Kodin zgjedhor. Sipas nenit 50 të këtij Kodi, në listat e zgjedhësve, për çdo qendër votimi, regjistrohen zgjedhësit që kanë vendbanimin në zonën e qendrës së votimit të njësisë së qeverisjes vendore si dhe zgjedhësit me vendqëndrim në zonën e qendrës së votimit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

Sipas nenit 50, pika 1, germa b) e Kodit zgjedhor, zgjedhësit duhet të jenë regjistruar në zyrat e gjendjes civile ose duhet të vërtetojnë vendqëndrimin e tyre në zonën përkatëse të qendrës së votimit gjatë procesit të hartimit të listave të zgjedhësve.

Një tjetër kërkesë e Kodit zgjedhor (neni 50, pika 2) është që zgjedhësit me vendqëndrim regjistrohen në listën e zgjedhësve vetëm pasi janë çregjistruar nga lista e zgjedhësve e vendbanimit të tyre.

Listat e zgjedhësve, sipas nenit 51 të Kodit zgjedhor, hartohen në zyrat e gjendjes civile sipas dokumentacionit që disponojnë në regjistrat themeltarë të gjendjes civile si dhe në regjistrin e shtetasve me vendqëndrim në zonën përkatëse të votimit. Sipas nenit 55 të Kodit zgjedhor, ky informacion dërgohet në Regjistrin kombëtar të gjendjes civile dhe në Regjistrin kombëtar të zgjedhësve, ku bëhet përpunimi përkatës. Mbas këtij përpunimi, bashkive dhe komunave u kërkohet të çregjistrojnë nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre zgjedhësit që janë regjistruar sipas vendqëndrimit.

Pas kësaj, bashkitë, njësitë bashkiake dhe komunat miratojnë dhe firmosin listën paraprake të zgjedhësve. Pikërisht këto lista administrohen nga KZQV-ja përkatëse. Kjo është procedura e hartimit dhe e miratimit të listave paraprake të zgjedhësve.

Pas shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve, sipas pikës 2 të nenit 57 të Kodit zgjedhor, çdo zgjedhës ka të drejtë të kërkojë korrigjimet në listat e zgjedhësve në rastet kur zgjedhësi: vdes, ka humbur të drejtën për të zgjedhur, është regjistruar në më shumë se një listë, ka ndryshuar vendbanimin ose vendqëndrimin, provon se të dhënat e tija vetjake nuk janë të sakta, është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit. Rishikimi i listave të zgjedhësve, sipas nenit 58 (pika 2) të Kodit zgjedhor bëhet me vendim të organit që ka hartuar listën mbi bazën e dokumenteve që janë paraqitur.

Sipas nenit 57, pika 2 e Kodit zgjedhor, kërkesa paraqitet në KZQV dhe përmban faktin për të cilin kërkohet ndryshimi në listë, dokumentet që e provojnë këtë fakt, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen dhe numrin e identitetit të zgjedhësit, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja. KZQV-ja vendos për këtë kërkesë brenda 7 ditëve nga depozitimi i saj. Për zgjedhësit që kanë vendbanimin në njësi të tjera vendore, vendimi merret pasi zgjedhësi është çregjistruar nga lista e zgjedhësve e qendrës së votimit ku ka vendbanimin.

PROBLEMET E KONSTATUARA NGA VËZHGIMET E KSHH-SË PËR LISTAT E ZGJEDHËSVE

Vëzhguesit e KSHH-së kanë raportuar për disa pasaktësi në listat e zgjedhësve, si raste kur personave nuk u figuronte emri në listë, kur emri i tyre ndodhej në një qendër tjetër votimi, kur persona të së njëjtës familje nuk e kishin emrin në të njëjtën qendër votimi dhe nuk ishin njoftuar paraprakisht për lëvizje në qendrën tjetër të votimit ose kur zgjedhësit gjenin emrat e tyre në listat e afishuara, por nuk ishin në listat e qendrave të votimit.

Këto parregullsi, natyrisht, krijuan shqetësime, sidomos në ata zgjedhës që ishin të predispozuar të ushtronin të drejtën e votes. Arsyet e këtij çrregullimi mund të jenë të shumta, por ne mendojmë se kryesoret janë:

Së pari, pas shpalljes së listave paraprake dhe atyre përfundimtare, sipas ligjit, KZQV-të, në bashkëpunim me bashkinë dhe komunën, duhej të organizonin lajmërimin për çdo zgjedhës, për qendrën e votimit, vendndodhjen e saj si dhe numrin e tyre në listën e zgjedhësve të qendrës së tyre të votimit (neni 56 i Kodit zgjedhor). Kjo dispozitë e Kodit zgjedhor duket se nuk është zbatuar siç duhet nga KQZV-të. Nga ana tjetër, Komiteti Shqiptar i Helsinkit është i mendimit se KQZ-ja ka punuar intensivisht për të informuar publikun për listat e zgjedhësve duke përdorur në mënyrë më të organizuar mjete të ndryshme, si median e shkruar, elektronike, spotet televizive, aksesin në internet dhe linjën telefonike falas.

Së dyti, pas shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve, një pjesë e zgjedhësve, për indiferentizëm ose të bindur se emri i tyre duhej të ishte në listë, nuk janë interesuar të njiheshin personalisht me listat. Ka pasur zgjedhës që edhe pse nuk e kanë pasur emrin në listë nuk i janë drejtuar KZQV-së përkatëse (kërkesë kjo e nenit 57 të Kodit zgjedhor).

Së treti, sipas nenit 58 të Kodit zgjedhor, partitë politike kanë të drejtë t'u drejtohen KZQV-ve për ndryshime në listat paraprake. Ankesat e tyre pjesërisht i kanë paraqitur në media ose në konferenca shtypi dhe pjesërisht në KZQV, por pa i shoqëruar në çdo rast me kërkesat personale të zgjedhësve, gjë që vonoi dhe vështirësoi verifikimet përkatëse.

Së katërti, KZQV-të nuk kanë treguar kujdesin e duhur dhe nuk kanë shqyrtuar në kohën e duhur ankesat e paraqitura në këto komisione dhe vendimet e marra prej tyre nuk janë bërë shpesh publike.

Së pesti, listat e zgjedhësve, pasi u miratuan përfundimisht, përsëri iu nënshtruan ndryshimeve si rrjedhojë e kërkesës së ndonjë partie politike.

Pavarësisht nga arsyet e mësipërme, që janë të karakterit subjektiv, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (ashtu siç është shprehur edhe në zgjedhjet e mëparshme) mendon se defekte të tilla në këtë ose atë masë do të vazhdojnë derisa ne nuk kemi të saktë dhe të stabilizuar në përputhje me ligjin regjistrin e zyrave të gjendjes civile, derisa nuk kemi të kompjuterizuar të dhënat që kanë të bëjnë me këtë problem dhe kështu nuk ka një sistem verifikues të dhënash.

KSHH-ja mendon se një pjesë e këtij defekti mund të parandalohet në qoftë se do të tregohej vëmendje më e madhe nga vetë zgjedhësit dhe nga subjektet zgjedhore

(sidomos nga dy partitë e mëdha). Ky defekt mund të ishte më i kufizuar në qoftë se KZQV-të përkatëse do të zbatonin me rigorozitet dispozitat e Kodit zgjedhor.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson të rëndësishme të diskutohet e drejta që Kodi zgjedhor u jep partive politike, subjekteve zgjedhore dhe institucioneve të tjera të interesuara që kërkojnë ndryshimin e listave paraprake. Kështu, në pikën 3 të nenit 58 të Kodit zgjedhor thuhet: “Kërkesa për ndryshime në listën paraprake mund të bëjnë edhe partitë politike, subjektet zgjedhore dhe institucionet e tjera të interesuara. Në çdo rast, kërkesat duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës...”, ndërsa kur subjektet e mësipërme kërkojnë ndryshime të vendbanimit ose të vendqëndrimit, kur të dhënat vetjake të zgjedhësit nuk janë të sakta ose kur ai është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit, kërkesës duhet t’i bashkëngjitet edhe “kërkesa personale e zgjedhësve”. Kemi mendimin se pika 3 e nenit 58 të Kodit zgjedhor është tepër e diskutueshme, veç të tjerave edhe për faktin se zbatimi i saj mund të ketë ndikuar edhe në çrregullimet⁵ e vërtetuara në listat e zgjedhësve të 12 tetorit të këtij viti.

Lidhur me defektet në listat e zgjedhësve e shohim të nevojshme të theksojmë se KSHH-ja vëzhgon respektimin e kërkesave të Kodit zgjedhor dhe nuk bëhet pjesë e komenteve politike. Në vëzhgimin e procesit zgjedhor në përputhje me ligjin, ne arrijmë në përfundime vetëm duke pasur parasysh ligjin dhe informacionet e verifikueshme që kemi marrë nga vëzhguesit tanë. Nëse pasaktësitë e vërtetuara në listat e zgjedhësve janë të qëllimshme, siç pretendohet nga kjo apo ajo forcë politike, nuk i takon KSHH-së, as ta mohojë dhe as ta miratojë. Për këtë ka organe kompetente që mund të arrijnë në përfundimet përkatëse.

⁵ Për një trajtim më të hollësishëm në lidhje me të drejtën që Kodi zgjedhor u jep partive politike në procesin e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve, lutemi shihni në pjesën “Përfundime dhe sugjerime lidhur me përmirësimin e Kodit zgjedhor dhe ecurinë e procesit zgjedhor, tetor 2003” në këtë raport.

6

DISA ÇËSHTJE LIDHUR ME FUSHATËN ZGJEDHORE DHE MEDIAN

Sipas nenit 133 të Kodit zgjedhor, fushata zgjedhore fillon 30 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë përpara fillimit të votimit. Në kundërshtim me këtë dispozitë, 2 partitë më të mëdha të opozitës dhe të pozitës, fushatën zgjedhore e filluan përkatësisht në datat 30 shtator dhe 1 tetor 2003. Kjo u pasua edhe nga partitë e tjera.

Fushata në përgjithësi ka qenë e qetë, veçanërisht propaganda zgjedhore e kandidatëve për kryetar bashkie dhe komune. Pozitive është që midis tyre janë organizuar edhe takime të përbashkëta televizive. Problematika ka qenë më pranë çështjeve që preokupojnë zgjedhësit, mgjithëse nuk kanë munguar edhe premtimet e paargumentuara.

KSHH-ja ka mendimin se gjuha e përdorur nga dy liderët e partive, përkatësisht PD-së dhe PS-së, në disa momente nuk ka qenë e ekuilibruar. Janë bërë akuza të ndërsjella për implikime ose veprimtari kriminale, madje në ndonjë rast është kaluar deri në cenimin e jetës private. Në disa qytete, si në Durrës, Korçë, Shkodër etj., ka pasur ankesa për grisje ose mosçaktivim vendesh për afishimin e materialeve propagandistike, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 135 të Kodit zgjedhor ku thuhet: "Organet e qeverisjes vendore caktojnë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike". Ky cënim i ligjit ka prekur më tepër partitë e vogla. Për zbatimin e këtij neni, KQZ-ja ka lëshuar edhe udhëzimin nr. 10, datë 27.IX.2003, për të cilin KSHH-ja mendon se ka qenë disi i vonuar.

Një tjetër çështje që vlen të përmendet në lidhje me fushatën zgjedhore është ajo e financimeve të partive politike për zgjedhjet e qeverisjes vendore. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi fondet publike për fushatën zgjedhore vetëm në datën 23 shtator 2003, pra tri javë pasi kishte filluar fushata zgjedhore. KSHH-ja mendon se ky fond duhej të ishte miratuar kohë më parë.

Për sa i përket mbulimit të fushatës nga media, KSHH-ja mendon se ai në përgjithësi ka qenë i ekuilibruar. Por, për gjuhën e dy organeve të partive më të mëdha, të pozitës dhe opozitës, d.m.th. "Zëri i popullit" dhe "Rilindja demokratike", mendon se në disa drejtime ka qenë agresive, pjesërisht me akuza dhe fyerje, pa pasur parasysh etikën gazetareske.

Për atë që mund të ndjekë emisionet televizive publike dhe private në lidhje me eksitet, teprimet ose njëanshmëritë, KSHH-ja mendon se mediat elektronike e kanë pasqyruar në përgjithësi drejt ecurinë e zgjedhjeve, megjithëse për këtë problem ka pasur edhe disa ankesa sidomos nga partitë e vogla.

Veç pasqyrimin të fushatës, shtypi i shkruar ka trajtuar edhe këto çështje:

- ☞ Zgjedhjen e një anëtari të KQZ-së
- ☞ Financimin me vonesë të fushatës së zgjedhjeve
- ☞ Amendamentet në ligjin “Për policinë” dhe aktin normativ të miratuar nga Këshilli i Ministrave “Për garantimin e procesit zgjedhor ditën e votimit”.

Në trajtimin e këtyre problemeve, veç aspektit ligjor, që ka qenë i kufizuar, vëmendja përqendrohej në atë politik. Kështu, p.sh., kritikohet vendimi i KLD-së, duke e akuzuar atë se kishte vepruar nën ndikimin politik të maxhorancës.

Për financimin e vonuar, media e shkruar kritikonte qeverinë, sepse vonesa ndikonte negativisht sidomos në fushatën zgjedhore të partive të vogla. Miratimi i aktit normativ konsiderohej i kundërligjshëm, sepse synonte manipulimin e zgjedhjeve etj.

KSHH-ja ka mendimin se dispozitat e parashikuara në Kodin zgjedhor për monitorimin e fushatës zgjedhore ku parashikohet edhe ngritja e bordit të monitorimit të medias, ka ndikuar në mënyrë pozitive.

7

PROCESI I VOTIMIT

Në përgjithësi, gjithë procesi zgjedhor, më 12 tetor 2003, u zhvillua në një situatë të qetë dhe pa incidente në të gjitha zonat e vëzhguara nga KSHH-ja. Në paragrafët e mëposhtëm paraqiten në mënyrë të përmbledhur, problemet e konstatuara në zonat ku kanë vepruar vëzhguesit e KSHH-së.

PROCEDURAT PËRPARA HAPJES SË VOTIMIT

Sipas nenit 97 të Kodin zgjedhor, një orë përpara hapjes së votimit, pra në orën 06:00 të datës 12 tetor 2003, KQV-ja, nën drejtimin e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit dhe në prani të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe të vëzhguesve, kryen disa detyra të përcaktuara në po këtë nen (neni 97, germa a-dh në Kodin zgjedhor). Në lidhje me punën përgatitore të anëtarëve të KQV-ve, vëzhguesit e KSHH-së kanë raportuar se qendrat e votimit u hapën përgjithësisht në orarin e përcaktuar me ligj. Megjithatë ka pasur edhe raste kur ato nuk janë hapur në këtë orar, pasi ka munguar një nga anëtarët e KQV-ve ose sekretari. Kjo dukuri përgjithësisht është vënë re në Durrës, Vlorë, Kukës (1 QV), Gjirokastër (4 QV), Fier (6 QV), Elbasan, Korçë dhe Shkodër (5 QV). Mungesa e sekretarëve ka ardhur më shumë edhe si rrjedhojë e zëvendësimit të tyre në orët e fundit para ditës së votimit.

Për sa i përket rregullsisë së qendrave të votimit, nga vëzhgimet e bëra, mund të themi se rezulton se ato kanë qenë përgjithësisht në gjendje të rregullt.

Gjatë gjithë procedurave përpara hapjes së votimit anëtarët e KQV-ve dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në përgjithësi kanë qenë të pranishëm, por ka pasur raste të mungesës së ndonjë anëtari të KQV-ve ose të ndonjë përfaqësuesi të partive politike, si në rrethet Tiranë (në 7 QV), Durrës (në 5 QV), në disa QV në Vlorë, Kukës (1 QV), Gjirokastër (3 QV), Fier (2 QV), Elbasan (3 QV), Korçë (3 QV) dhe Shkodër (2 QV).

Në të gjitha qendrat e votimit ku vëzhguesit e KSHH-së kanë qenë të pranishëm kutitë e votimit kanë qenë të kontrollohuara dhe materialet e marra në dorëzim janë kontrolluar nga anëtarët e KQV-ve. Në përgjithësi, procesverbali është nënshkruar nga të gjithë personat e autorizuar në bazë të ligjit me përjashtim të 5 qendrave në Tiranë, 1 qendre në Gjirokastër dhe 1 qendre në Durrës, ku nuk kanë nënshkruar anëtarët ose përfaqësuesit të cilët nuk kanë qenë të pranishëm gjatë ditës së votimit.

Për sa i përket afishimit të udhëzimeve të votimit në një vend të përshtatshëm, kjo kërkesë e nenit 97, germa c, të Kodit zgjedhor, përgjithësisht është zbatuar, por në 5 qendra votimi në Tiranë, në 3 qendra në Vlorë dhe 2 qendra në Kamëz, ato nuk ishin të afishuara.

Në kundërshtim me ligjin ka qenë prania e materialeve propagandistike brenda rrezes prej 150 m nga qendra e votimit në 13 qendra votimit në Tiranë, 3 në

Kamëz, 1 në Kukës, 2 në Gjirokastrë, 2 në Fier, 3 në Shkodër, 2 në Elbasan, 3 në Korçë, 3 në Vlorë dhe 6 qendra votimi në Durrës, duke shkelur kështu nenin 97, germa b, të Kodit zgjedhor.

HAPJA E VOTIMIT DHE PROCEDURAT GJATË VOTIMIT

Hapja me vonesë e disa qendrave të votimit dhe përgatitja paraprake e materialeve të votimit kanë ndikuar në fillimin e procesit të votimit me vonesë. Raste të tilla vëzhguesit e KSHH-së kanë vënë re në 2 qendra votimi në Tiranë, 9 në Durrës, 2 në Vlorë, 1 në Kukës, 1 në Gjirokastrë, 4 në Fier, 1 në Shkodër, 3 në Korçë dhe 1 në Kamëz.

Në përgjithësi, në të gjitha rastet, përpara se të votonte, zgjedhësi tregonte dokumentin e identifikimit me përjashtim të një qendre votimi në Kukës dhe të disa rasteve në Vlorë. Ka pasur raste, pothuajse në të gjitha zonat e vëzhguara nga KSHH-ja, në të cilat zgjedhësi është pranuar edhe me kartën e votuesit, megjithëse, në bazë të udhëzimit të KQZ-së, karta e votuesve nuk radhitej ndër dokumentet identifikuese për të votuar. Udhëzimi i KQZ-së ka përcaktuar tri dokumente për identifikimin e zgjedhësve: pasaportën, letërnjoftimin dhe certifikatën me foto. Në rastet kur karta e votuesve nuk është pranuar si e vlefshme për të identifikuar zgjedhësin, kjo ka sjellë pështjellim tek zgjedhësit.

Vlen të përmendet se ky pështjellim tek anëtarët e KQV-ve në lidhje me pranimin e kartave të votuesve si dokument identifikimi ka ardhur si rrjedhojë e informacionit kontradiktor që u është servirur anëtarëve të KQV-ve në Manualin e trajnimit ku, ndryshe nga udhëzimi i KQZ-së, në listën e dokumenteve të identifikimit për t'u përdorur nga zgjedhësit është përfshirë edhe karta e votuesve.

Në të gjitha rastet fleta e votimit i jepej votuesit pasi vulosej nga sekretari i KQV-së.

Problem tjetër i konstatuar gjatë procesit të votimit ka qenë ai i mosfunksionimit të llambave identifikuese me rreze ultravjollcë ose i përdorimit të gabuar të tyre, si p.sh., është bërë timbrosja në gisht e zgjedhësve përpara verifikimit të emrit të tyre në listë.

Brenda qendrave të votimit të vëzhguara nga KSHH-ja nuk ka pasur në asnjë rast persona të armatosur. Për rivendosjen e rendit, KQV-të nuk e kanë pasur të nevojshme të thërresin policinë, me përjashtim të 1 qendre votimi në shkollën "Vasil Shanto" në Shkodër ku KQV-së iu desh të thërriste policinë, pasi vodhën kutinë e votimit.

Sipas nenit 103 të Kodit zgjedhor, "Zgjedhësi që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit". Në përgjithësi, kjo dispozitë ligjore është respektuar në të gjitha qendrat e vëzhguara nga KSHH-ja, por ka pasur raste, si p.sh., në disa qendra votimi të Elbasanit, ku nuk është mbajtur procesverbal sipas nenit 103 të Kodit zgjedhor. Në këtë nen thuhet: "Para se të shënojë fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në procesverbal se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër". Gjithashtu, ka pasur raste, si në 2 qendra votimi në Vlorë, ku anëtarët e KQV-ve kanë ndihmuar personat që nuk mund të votojnë vetë duke shkelur kështu nenin 103, pika 4, të Kodit zgjedhor, si edhe disa raste në Tiranë ku një person ka ndihmuar më shumë se një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë, duke mos respektuar kështu nenin 103, pika 2 të Kodit zgjedhor.

Pothuajse në të gjitha zonat e vëzhguara nga KSHH-ja ka pasur raste në të cilat votuesit nuk kanë mundur të votonin megjithëse e kanë pasur emrin në listat paraprake⁶. Ky problem ka qenë i përgjithshëm për të gjitha qendrat e votimit të vëzhguara. Arsyet kanë qenë kryesisht mospasja e emrit në listën përfundimtare të votuesve, pasaktësitë në regjistrimin e emrit në listë ose rastet kur emri i zgjedhësve ishte regjistruar në një tjetër qendër votimi, për të cilën këta të fundit nuk kishin dijeni. Arsye të tjera kanë qenë të rralla dhe të karakterit teknik (dokument identifikimi pa fotografi etj.).

Në shumë raste, për mosgjatjen e emrave të tyre në listat e zgjedhësve, zgjedhësit janë udhëzuar të shkojnë në gjykatat e rretheve, si në Korçë, Kukës, Fier, Tiranë etj. Ky instruktim nga ana e KQV-ve ka qenë çorientues për zgjedhësit, pasi dihet se, sipas nenit 57, pika 6 e Kodit zgjedhor, thuhet: "Kundër vendimit të KZQV-së mund të bëhet ankim brenda 48 orëve nga momenti i shpalljes publike në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ndodhet KZQV-ja. Gjykata gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre anëtarë dhe merr vendim brenda dy ditëve. Vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor është përfundimtar". Pra, duhej të ishte marrë më parë një vendim i KZQV-së përkatëse për kërkesat personale të zgjedhësve në lidhje me rishikimin e listave paraprake të zgjedhësve dhe pastaj ky vendim të ankimohej nga zgjedhësi në rast se ky i fundit nuk ishte dakord me vendimin e KZQV-së përkatëse. Vetëm në këtë moment zgjedhësi ankimon vendimin e KZQV-së brenda 48 orëve në gjykatën përkatëse të rrethit. Drejtimi i zgjedhësve drejt gjykatave të rretheve, më datën 12 tetor 2003, ka qenë i pabazuar në Kodin zgjedhor si edhe ka sjellë pështjellim të mëtejshëm tek zgjedhësit.

Edhe ndryshimi i vendndodhjes së qendrave të votimit në prag të ditës së votimit, në disa zona ku ka vëzhguar KSHH-ja, si edhe fakti që zgjedhësit rezultuan të mos kishin dijeni për këto ndryshime të minutës së fundit i ka lënë ata, gjithashtu, të paqartë. Dukuritë e mësipërme, fatkeqësisht, kanë çuar në hutimin e zgjedhësve dhe ky shqetësim është ngritur nga pothuajse të gjithë vëzhguesit tanë në të nëntë zonat e vëzhguara nga KSHH-ja.

Në disa qendra votimi në Tiranë, në 1 qendër votimi në Gjirokastrë, 2 qendra votimi në Fier dhe Shkodër ka pasur fluks të madh zgjedhësish gjë që ka sjellë vështirësi në lëvizjen e tyre brenda qendrave të votimit. Duhet pasur parasysh këtu edhe fakti se ambientetet e disa qendrave kanë qenë të vogla.

Në shumicën e qendrave të votimit të vëzhguara, kutitë e votimit u mbushën shpejt, sepse fletët e votimit ishin të mëdha. KSHH-ja, që në orët e para të mëngjesit të datës 12 tetor 2003, sinjalizoi menjëherë për këtë problem KQZ-në. Por KQZ-ja, megjithëse bëri përpjekje të mëdha për të dërguar kuti të tjera votimi aty ku nevojiteshin, duhej ta kishte parashikuar këtë problem dhe ta kishte shmangur atë. Megjithatë, nga vëzhguesit tanë nuk ka pasur informacione që tejmbushja e kutive të këtë sjellë pamundësinë e votimit ose të largimit të zgjedhësve pa votuar.

Nuk ka pasur raste në të cilat zgjedhësi nuk është pajisur me fletë votimi. Gjithashtu, përgjithësisht, nuk ka pasur raste në të cilat të vihej në dyshim identiteti i votuesit. Rastet kur votuesit janë paraqitur me vendim gjykate kanë qenë të rralla në qendrat e votimit të vëzhguara, por edhe në këto raste zgjedhësi është lejuar të votojë.

Në zonat e vëzhguara janë vërejtur edhe raste të futjes në dhomën e fshehtë të disa zgjedhësve familjarisht dhe është vënë re se votuesi shoqërohej nga familjarët e tij ose nga anëtarët e komisionit. Ka pasur raste të votimit të bashkëshortëve së bashku në dhomën e fshehtë. Rastet e lartpërmendura janë vënë re në disa zona, si në Tiranë, Kamëz, Elbasan, Kukës dhe Vlorë.

⁶ Për më shumë informacion rreth kësaj çështjeje është folur në pjesën "Listat paraprake të zgjedhësve, rishikimi i tyre dhe problemet e dala nga vëzhgimet e KSHH-së" në këtë raport.

Në zonat e vëzhguara nga KSHH-ja nuk ka pasur raste ku të jetë ushtruar presion ndaj KQV-ve, përveç dy rasteve në Vlorë, në 2 qendra votimi, dhe një në Tiranë, ku një nga kandidatët për kryetar bashkie për rrethin e Tiranës është munduar t'u imponohet anëtarëve të KQV-së, përfaqësues të partisë politike të kandidatit. Kjo çoi në pezullimin e përkohshëm të procesit të votimit. Gjithashtu, nuk janë raportuar raste të ushtrimit të presionit ndaj votuesve.

PROCEDURAT E MBYLLJES SË PROCESIT TË VOTIMIT

Për sa i përket procesit të mbylljes së votimit, për zonat e vëzhguara, rezulton se përgjithësisht ai ka qenë i qetë dhe në përputhje me ligjin. Pjesa më e madhe e qendrave të votimit janë mbyllur në orën 19:00. Vetëm në disa raste, si në 2 qendra votimi në Gjirokastrë, 1 në Shkodër, Elbasan dhe Fier, si edhe në 3 qendra votimi në Korçë, këto të fundit janë mbyllur pak minuta më vonë se ora 19:00, pasi ka pasur votues që pritnin të votonin. Për sa i përket bashkisë së Tiranës, KQZ-ja mori vendim që qendrat e votimit të mbylleshin në orën 20:00 dhe ky orar u respektua në pothuajse të gjitha qendrat e votimit, përveç një qendre e cila u mbyll në orën 19:40, pra përpara orarit të përcaktuar nga KQZ-ja.

Nga raportet e vëzhguesve të KSHH-së është theksuar se, në përgjithësi, janë respektuar procedurat e përcaktuara qartë në nenin 109 të Kodit zgjedhor në lidhje me numërimin e votave nga KQV-të. Gjatë këtyre procedurave kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e partive politike dhe vëzhguesit, ashtu siç e parashikon Kodi zgjedhor.

Gjatë numërimit të votave, në shumicën e qendrave të votimit ka qenë një klimë e qetë, megjithatë, në disa qendra votimi në Tiranë, 1 qendër votimi në Gjirokastrë, 1 në Fier, 3 në Shkodër, 3 në Korçë dhe në disa qendra votimi në Elbasan ka pasur raste të debateve mes anëtarëve të KQV-ve. Këto debate kanë qenë të karakterit teknik, debate në lidhje me numërimin e votave, në lidhje me vlefshmërinë e fletëve të votimit etj.

Gjatë hartimit të tabelës së rezultateve, në pjesën më të madhe të qendrave të votimit të vëzhguara të Tiranës nuk ka pasur debate mes anëtarëve të KQV-ve, me përjashtime të vogla. Mund të përmendim se nga qendrat e votimit të vëzhguara në Tiranë, në 4 qendra votimi tabelat nuk u firmosën nga të gjithë anëtarët e KQV-ve.

Në Tiranë dhe Durrës, të gjithë personat e pranishëm në QV, të përcaktuar në nenin 105 të Kodit zgjedhor, janë pajisur me tabelat e rezultateve. Megjithatë, në një qendër votimi në Tiranë dhe 1 qendër votimi në Korçë vëzhguesit e KSHH-së nuk janë pajisur me tabelën e rezultateve për shkak se ato ishin në numër të kufizuar dhe anëtarët e KQV-së nuk e njihnin të drejtën për pajisjen me një kopje të kësaj table qe Kodi zgjedhor, në nenin 109, germa f), u njeh vëzhguesve.

Pas përfundimit të numërimit të votave dhe hedhjes në tabelë të rezultateve, materialet e votimit janë administruar nga KQV-të përkatëse në përputhje me ligjin në të gjitha qendrat e votimit të vëzhguara nga KSHH-ja në shkallë vendi. Kutitë e votimit janë vulosur në të gjitha qendrat e votimit të vëzhguara nga KSHH-ja, me përjashtim të një qendre votimi në Kukës. Nuk janë vënë re presione ndaj anëtarëve të KQV-së nga jashtë qendrave të votimit.

8

ÇËSHTJE TË TJERA

Vlen të përmendet se vëzhguesit e KSHH-së, në raportet e tyre, vënë në dukje faktin që anëtarët e KQV-ve dhe KZQV-ve të vëzhguara gjatë procesit parazgjedhor, gjatë ditës së votimit dhe gjatë procesit paszgjedhor kanë vlerësuar pozitivisht rolin e vëzhguesit të KSHH-së në shumicën e rasteve. Gjithashtu, ata kanë mirëpritur vërejtjet me shkrim të lëna nga vëzhguesit e KSHH-së sidomos gjatë ditës së votimit. Ky vlerësim nuk ka të bëjë vetëm me reputacionin e KSHH-së, por edhe me faktin se vëzhguesit e këtij Komiteti kanë zbatuar drejt detyrat e përcaktuara në Kodi zgjedhor.

KSHH-ja⁷ ka mbajtur kontakte sistematike me KQZ-në për pengesat, vështirësitë dhe shkeljet e ligjit, të evidentuara gjatë gjithë procesit zgjedhor dhe, në disa raste, është shprehur edhe publikisht⁸. Vërejmë me kënaqësi se sugjerimet e KSHH-së jo vetëm janë mirëpritur nga ky organ, por edhe janë marrë masa për përmirësimin e situatës, kur kjo ka qenë e nevojshme.

Ky konstatim, i parë nga një këndvështrim më i gjerë, është shumë pozitiv. Shoqëria shqiptare në përgjithësi dhe, në veçanti, strukturat qendrore dhe ato lokale përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të tetorit 2003 po sensibilizohen për ndihmesën modeste, por shumë të nevojshme të dhënë nga aktorët e shoqërisë civile, siç është edhe ndihmesa e KSHH-së në rolin e vëzhguesit vendor për zgjedhjet e tetorit 2003.

⁷ Për më shumë informacion në lidhje me komunikimin zyrtar midis KSHH-së dhe KQZ-së, lutemi lexoni në aneks nr.3 në këtë raport.

⁸ Për më shumë informacion rreth deklaratave publike të KSHH-së, lutemi lexoni në aneks nr.2.

9

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME LIDHUR ME PËRMIRËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR⁹ DHE ECURINË E PROCESIT ZGJEDHOR, TETOR 2003

PËRFUNDIME

KSHH-ja, bazuar në vëzhgimet e saja në lidhje me zbatimin e Kodit zgjedhor gjatë procesit zgjedhor të tetorit 2003, paraqet këto konkluzione:

1. Kodi zgjedhor¹⁰ i ri shënon një hap pozitiv drejt përmirësimit të legjislacionit zgjedhor në krahasim me Kodin zgjedhor të shfuqizuar, por në disa drejtime ai lë shumë për të dëshiruar.
2. KQZ-ja ka kryer më mirë dhe më me kompetencë detyrat e përcaktuara në Kodin zgjedhor. Kjo u vu re në funksionimin normal, publik dhe transparent të tij dhe veçanërisht në zbatimin e procedurave ligjore gjatë shqyrtimit të ankesave, megjithëse gjatë procesit paszgjedhor (si p.sh., shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të tetorit 2003) ka ngurruar për të vepruar më me shpejtësi për t'i dhënë zgjidhje situatës së krijuar.
3. Kodi zgjedhor kërkon baraspeshë politike në KQZ, KZQV dhe KQV, gjë që solli probleme të natyrave të ndryshme, si zvarritje ose bllokim të procesit të shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të tetorit 2003.
4. Presioni politik mbi organet përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve, si KQZ-në, KZQV-të dhe KQV-të, ka qenë i pranishëm dhe disa herë shumë i madh, gjë që ka ndikuar në vonesa dhe bllokim të disa proceseve zgjedhore.
5. Ka pasur vonesa në ngritjen e KZQV-ve dhe të KQV-ve. Kjo ka ndodhur për shkak të vonesave në propozimet e paraqitura nga partitë përkatëse politike.
6. Trajnimet e anëtarëve të KZQV-ve dhe të KQV-ve ishin të vonuara, si rrjedhim edhe cilësia në këto trajnime nuk ka qenë në nivelin e duhur për një njohje më të mirë të legjislacioni zgjedhor.

⁹ Lidhur me Kodin zgjedhor dhe përmirësimin e tij, KSHH-ja ka edhe mendime të tjera, por ato kërkojnë një studim më të thelluar për të dalë me propozime konkrete. Ndoshta për këtë do të duhej edhe mendimi i një rrethi më të gjerë të specialistëve dhe në mënyrë të veçantë i atyre që kanë përvojë në këtë fushë.

¹⁰ Për sa u përket vërejtjeve dhe sugjerimeve për ndryshime në Kodin zgjedhor, lutemi lexoni më poshtë në këtë pjesë.

7. Zëvendësimet e një numri të konsiderueshëm komisionerësh disa orë përpara ditës së votimit çoi në funksionimin jo të mirë të komisioneve zgjedhore lokale, i cili u evidentua sidomos gjatë procesit të shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.
8. U vunë re mangësi të shumta në lidhje me listat e zgjedhësve, të cilat sollën pështjellim tek zgjedhësit gjatë ditës së votimit. Gjithashtu, këto parregullsi sollën për rrjedhojë faktin që zgjedhësit, të cilët donin të ushtronin të drejtën e votës, të mos e ushtronin këtë të drejtë.
9. U vu re indiferentizëm dhe neglizhencë nga ana e zgjedhësve për të ndjekur procedurat e parashikuara në Kodin zgjedhor për të verifikuar nëse emri i tyre figuronte në listat e zgjedhësve.
10. Fushata zgjedhore u zhvillua e qetë dhe përgjithësisht pa incidente.
11. Mbulimi i fushatës zgjedhore nga media në përgjithësi ka qenë i ekuilibruar, megjithëse trajtimi i disa çështjeve në median e shkruar ka qenë më shumë i karakterit politik sesa ligjor.
12. Financimet e partive politike për fushatën zgjedhore u bënë me vonesë.
13. Situata gjatë procesit të votimit ishte e qetë dhe përgjithësisht pa incidente në zonat e vëzhguara nga KSHH-ja.
14. Janë vënë re një sërë parregullsish gjatë procedurave të hapjes së qendrave të votimit, gjatë procesit të votimit si edhe në procesin e shpalljes së rezultatit nga KQV-të dhe shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KZQV-të përkatëse.
15. Pati pështjellim tek zgjedhësit gjatë ditës së votimit. Ata nuk e gjenin emrin në listë, u drejtoheshin gjykatave të rretheve përkatëse ose shtabeve elektorale të subjekteve politike për t'u informuar se ku mund ta gjenin emrin e tyre në listat e zgjedhësve.
16. KQZ-ja nuk i kishte parashikuar si duhet problemet e kutive të votimit të cilat u mbushën shpejt, pasi fletët e votimit në këto zgjedhje ishin të mëdha.
17. Ndryshimi i vendndodhjes së një numri qendrash votimi në çastet e fundit para ditës së votimit çoi në pështjellimin e zgjedhësve në ditën e votimit.
18. Procesi i mbylljes së votimit në zonat e vëzhguara nga KSHH-ja ka qenë i qetë dhe në përputhje me ligjin. Megjithëse, në disa raste, gjatë procesit të nxjerrjes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, midis anëtarëve të KQV-ve ka pasur debate të karakterit teknik.
19. Forcat e policisë së shtetit kanë respektuar dispozitat ligjore të Kodit zgjedhor duke përmbushur me sukses funksionin e tyre gjatë procesit zgjedhor.
20. Pozitiv ka qenë konstatimi se, përgjithësisht, administrata zgjedhore për zgjedhjet e tetorit 2003 ka vlerësuar kontributin modest dhe të nevojshëm të vëzhguesve vendës, në përgjithësi, dhe atyre të KSHH-së, në veçanti.

SUGJERIME PËR KODIN ZGJEDHOR¹¹

Përvoja e zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore bën të nevojshme që, në të ardhmen, Kodi i ri zgjedhor të pësojë disa ndryshime. Objekt diskutimi dhe debati meritojnë këto çështje:

1. KQZ-ja, KZZ-ja dhe KZQV-të të mos krijohen në bazë të propozimeve të partive politike përkatëse, por të diskutohen variante të tjera më të përshtatshme që do të garantonin pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.

¹¹ KSHH planifikon të iniciojë një tryezë ekspertësh ku do të diskutohen çështjet që janë ngritur në këtë pjesë të raportit me qëllim përmirësimin e KZ në të ardhmen.

Një nga këto variante mund të ishte testimi i tyre në bazë të kritereve profesionale afërsisht siç veprohet për nëpunësit e shërbimit civil. Përsa u përket KQV-ve (për shkak të numrit shumë të madh të anëtarëve të këtyre komisioneve dhe shpenzimeve të shumta që mund të nevojiteshin) mund të vazhdohej me propozime nga subjektet zgjedhore, por të rishikoheshin kompe-tencat e tyre dhe procedurat që duhet të ndiqeshin.

2. Pas shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve, të drejtën për të kërkuar korrigjimin e tyre (për shkak të pasaktësive, mungesave etj.) ta kenë vetëm zgjedhësit dhe jo edhe partitë politike, subjektet zgjedhore dhe institucionet e tjera të interesuara, siç përmendet në pikën 3 të nenit 58 të Kodit zgjedhor. Jemi për shfuqizimin e kësaj dispozite, sepse zbatimi i saj mund të shoqërohet me pasoja të dëmshme sidomos në rastet kur KZQV-të vendosin refuzimin tërësisht ose pjesërisht të kërkesave të tyre. E theksojmë këtë edhe për faktin se të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit e kanë vetëm zgjedhësit.
3. Të shikohet kushtetësia e pikës 2 të nenit 23 të Kodit ku thuhet se, në rastet e ndalimit apo të arrestimit të anëtarëve të KQZ-së duhet të njoftohet Gjykata Kushtetuese, e cila vendos. Kjo kompetencë e Gjykatës Kushtetuese nuk është përcaktuar në Kushtetutë, prandaj nuk mund të rregullohet me një ligj të veçantë.
Të shikohen, gjithashtu, edhe pikat 1 dhe 3 të nenit 24 të Kodit ku bëhet fjalë për rastet e shkarkimit të anëtarit të KQZ-së me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit (sepse për këtë nuk bëhet fjalë në Kushtetutë). Kjo vjen në kundërshtim me nenin 87 të Kushtetutës, si dhe ajo që thuhet në nenin 25 të Kodit për mbarimin para afatit të mandatit të anëtarit të KQZ-së (sepse për këtë nuk bëhet fjalë në Kushtetutë) dhe Gjykata Kushtetuese në një rast analog është shprehur se ky rregullim nuk mund të bëhet me ligj.
4. Lidhur me përtëritjen e përbërjes së KQZ-së, në nenin 154 të Kushtetutës thuhet: “Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përtërihet çdo tre vjet sipas procedurës së përcaktuar me ligj”. Kjo procedurë e detajuar ishte përcaktuar në nenin 25 të Kodit të shfuqizuar zgjedhor, ndërsa në Kodin e ri, jo. Ky është detyrim kushtetues dhe nuk mund të anashkalohet.
5. Kërkesa në Kodin e ri që, për të marrë vendim, për disa çështje kërkohet votimi “pro” i pesë anëtarëve mendojmë se duhet të shikohet. Përvoja e zgjedhjeve të 12 tetorit vërtetoi se zbatimi i kësaj kërkesë shkaktoi zvarritjen në shqyrtimin e çështjeve edhe në shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve.
6. Sugjerojmë që në Kodin e përmirësuar, KQZ-së t’i jepet e drejta që të shpallë edhe rezultate të pjesshme kur ka përfunduar procedura e ankimeve administrative dhe në gjykatë. Do të sugjeronim që afati shtatëditor për shqyrtimin e çështjeve nga Kolegji Zgjedhor i gjykatës së apelit të reduktohej në pesë ditë.
7. Në Kodin zgjedhor të përcaktohet më qartë se zgjedhësi që ka paraqitur ankesë në KZQV për korrigjimin e listës paraprake të shpallur duhet të njoftohet zyrtarisht për vendimin e marrë nga KZQV-ja lidhur me këtë kërkesë. Të theksohet, gjithashtu, se edhe në rastet kur është pranuar kërkesa e tij, por në fakt emri i tij nuk figuron në listën përfundimtare, të ketë të drejtën e ankimit në gjykatë (në qoftë se çështja nuk zgjidhet në rrugë administrative).
8. Për të krijuar mundësinë e hartimit të listave të zgjedhësve sa më të plota

dhe të sakta do të ishte e nevojshme të rishikoheshin dhe të plotësoheshin aktet nënligjore që kanë të bëjnë me regjistrat e gjendjes civile. Veç kësaj, del nevoja e kompjute-rizimit dhe e krijimit të mekanizmave të kontrollit të saktësisë së këtyre regjistrave, gjë që do të krijonte edhe mundësinë e krijimit të regjistrit themeltar me një vërtetësi më të madhe. Pa marrjen e këtyre masave do të ishte vështirë të shmangeshin rastet kur mjaft zgjedhës të ngeleshin pa votuar.

9. Në Kodin zgjedhor (pika 3 e nenit 33) thuhet se përfaqësuesit e shtatë partive politike janë me status të përhershëm pranë KQZ-së dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet që zhvillon KQZ-ja edhe jashtë periudhës zgjedhore. Sugjerojmë që kjo dispozitë të rishikohet sepse partia politike merr cilësinë e subjektit zgjedhor kur regjistrohet në KQZ dhe, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, nuk do të kishte kuptim që përfaqësuesi i tij të kishte status të përhershëm dhe të merrte pjesë në mbledhjet e KQZ-së edhe jashtë periudhës zgjedhore.
10. Në Kodin e ri do të ishte mirë të parashikoheshin dispozitat tranzitore ku, veç të tjerave, të bëhej fjalë edhe për mandatin e personave të zgjedhur më parë, gjë që do të parandalonte ndërprerjen e mandatit të tyre të parakohshëm për shkak të ndryshimeve në Kodin zgjedhor. Këtu është fjala sidomos për anëtarët e KQZ-së.
11. Në nenin 167 të Kodit zgjedhor thuhet se gjyqtari i Kolegjit zgjedhor nuk mund t'i nënshtrohet procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar Kolegji. Sugjerojmë që edhe kjo dispozitë të rishikohet, sepse, kur vërtetohen shkelje të tilla për të cilat ai duhet t'i nënshtrohet procedimit disiplinor, si edhe gjyqtarët e tjerë, nuk ka pse të privilegjohet.
12. KSHH-ja nuk mendon se është e drejtë ajo që thuhet në nenin 140 të Kodit zgjedhor dhe, konkretisht, kur flitet për të drejtën e KQZ-së që të urdhërojë KKRT-në për ekzekutimin e vendimeve që ai merr. E themi këtë sepse KKRT-ja është një organ i pavarur dhe i zgjedhur nga Kuvendi dhe jo organ i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve.

SUGJERIME TË TJERA

KSHH-ja, bazuar në konkluzionet e vëzhgimeve të saja të procesit zgjedhor tetor 2003, paraqet këto sugjerime:

1. Të merren masa nga KQZ-ja për të organizuar trajnime më të plota dhe më cilësore për anëtarët e KZQV-ve dhe të KQV-ve që, si rrjedhim, do të sigurojnë njohje më të mirë të Kodit zgjedhor nga ana e anëtarëve dhe një zbatim më rigoroz të tij gjatë aspekteve të ndryshme të procesit zgjedhor në të ardhmen.
2. Të merren masa më efikase nga ana e KZQV-ve që, në bashkëpunim me bashkinë dhe komunën përkatëse, të lajmërojnë çdo zgjedhës për qendrën e votimit dhe vendndodhjen e saj si edhe numrin rendor në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit.
3. Të shmangen vonesat në lidhje me financimet e partive politike për fushatën zgjedhore.
4. Të merren masa nga ana e KQZ-së për të shmangur probleme të caktuara me infrastrukturën e zgjedhjeve, siç ishte rasti i kutive të votimit.
5. Vëzhguesit vendës të vazhdojnë praktikën e mirë që u vu re sidomos gjatë këtyre zgjedhjeve duke rritur rolin e tyre si vëzhgues të zgjedhjeve në të ardhmen.

Sh tojcë nr. 1

PËR VEPRIMTARINË E KSHH-SË NË KUADËR TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË TETORIT 2003

Gjatë periudhës gusht - tetor 2003, KSHH-ja u angazhua në zbatimin e projektit: "Edukimi ligjor i zgjedhësve dhe vëzhgimi i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore 2003", financuar nga Komisioni për Demokraci, ambasada e SHBA në Tiranë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e çmon si përgjegjësine e tij të marrë pjesë aktive në vëzhgimin e respektimit të të drejtave politike, siç është e drejta e ushtrimit të votës nga qytetarët shqiptarë, si edhe në vëzhgimin e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të tetorit 2003. Vlen të përmendet se, duke filluar nga vitet '90, KSHH-ja ka vëzhguar zgjedhjet parlamentare dhe ato për organet e qeverisjes vendore në Shqipëri. Bazuar në përvojën e tij të pasur nëpërmjet veprimtarive të zhvilluara në kuadër të këtij projekti, Komiteti Shqiptar i Helsinkit kontribuoi në:

- rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë gjithë procesit zgjedhor;
- rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të drejtuesve të forcave të rendit në përgjithësi dhe të komisariateve të policisë në veçanti për detyrat dhe të drejtat e tyre përpara, gjatë dhe pas ditës së votimit sipas Kodit zgjedhor;
- respektimin më të mirë të të drejtave politike e sidomos të ushtrimit të së drejtës së votës të qytetarëve të thjeshtë shqiptarë;
- zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike nëpërmjet punës së tij si vëzhgues dhe edukues gjatë zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore 2003;
- forcimin e rolit të vëzhguesit të brendshëm në procesin zgjedhor.

Në paragrafët që vijojnë do të paraqesim shkurtimisht aktivitetet e kryera nga KSHH-ja në kuadër të këtij projekti, me anë të të cilave u realizuan objektivat e lartpërmendur.

PËRZGJEDHJA E VËZHguesVE DHE AKREDITIMI I TYRE

KSHH-ja i kushtoi kujdes përzgjedhjes së vëzhguesve. Në këtë proces, ky Komitet mbajti parasysh natyrën e veprimtarisë së tij, kërkesat e Kodit zgjedhor dhe udhëzimin e KQZ-së në lidhje me të drejtën për të caktuar vëzhgues. KSHH-ja përzgjodhi 106 vëzhgues, ndër të cilët një pjesë prej tyre kishin përvojë në vëzhgimet e zgjedhjeve ose në vëzhgime të tjera të KSHH-së. Në bazë të kërkesës zyrtare të KSHH-së, më datën 4 shtator 2003, KQZ-ja akreditoi 106 vëzhgues afatgjatë.

TRAJNIMI I VËZHguesVE

Në datat **5 dhe 6 shtator 2003**, KSHH-ja organizoi një trajnim dyditor të vëzhguesve të tij. Qëllimi i trajnimit ishte njohja e vëzhguesve me Kodin e ri zgjedhor (KZ) dhe zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore. Në këtë trajnim u zbërthyen dhe u bënë të qarta jo vetëm dispozitat e këtij Kodi, por edhe metodologjia e vëzhgimit si edhe mënyra e raportimit pranë KSHH-së në lidhje me fushatën zgjedhore, paraqitjen e dokumentacionit të kandidatëve, listat paraprake të zgjedhësve dhe procedurat për korrigjimin e tyre, procedurat në KZQV dhe KQV-të, procesi i votimit dhe procedurat pas ditës së votimit, procedurat ankimore etj. Vëmendje e veçantë në këtë trajnim iu kushtua rolit të vëzhguesit vendës në këtë proces.

Trajnimi u krye nga një staf i kualifikuar i KSHH-së. Për pjesëmarrësit në trajnim u përgatitën materiale të dobishme për të kuptuar dhe për të zbërthyer çështjet e lartpërmendura.

Gjithashtu, stafi i projektit të KSHH-së, në mënyrë të vazhdueshme, organizoi takime me vëzhguesit e tij për të sqaruar objektin e vëzhgimit për secilin mision vëzhgimi, për të vënë në dijeni dhe për të zbërthyer udhëzimet e nxjerra nga KQZ-ja gjatë procesit parazgjedhor si edhe për të trajtuar të gjitha problemet që mund të lindnin gjatë vëzhgimit.

KONTRIBUTI I KSHH-SË NË TRAJNIMIN E POLICISË

Mbështetur në rolin e Policisë së Shtetit në procesin zgjedhor, në datat **23-25 shtator 2003**, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me KSHH-në, zhvilloi një seminar trajnues me përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Rendit Publik, me shefat e komisariateve dhe të rendit të të gjithë vendit.

Nëpërmjet këtij seminari u synua njohja më e mirë e Kodit zgjedhor, e rolit dhe e përgjegjësisë së Policisë së Shtetit para, gjatë dhe pas ditës së votimit etj. Përfaqësues të Ministrisë së Rendit Publik, KQZ-së, Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Komisionit Parlamentar për Rendin dhe SHISH-in si edhe përfaqësues nga forcat e huaja policore diskutuan rreth rolit dhe rëndësisë së veçantë të Policisë së Shtetit, si një strukturë e depolitizuar, në mbarëvajtjen e një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm dhe demokratik.

KSHH-ja ofroi trajnim për një njohje dhe kuptim më të mirë të Kodit zgjedhor dhe të përmbushjes nga ana e Policisë së Shtetit të së drejtës për të votuar dhe detyrimin që u ngarkon ligji në këtë proces.

PUBLIKIMET SENSIBILIZUESE TË KSHH-SË

KSHH-ja i kushtoi vëmendje të veçantë rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë gjithë procesit zgjedhor nëpërmjet **fletëpalosjes** dhe **broshurës** "Kodi zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, tetor 2003".

Fletëpalosja e përgatitur me një gjuhë të thjeshtë i njëjtte zgjedhësit me disa procese të rëndësishme parazgjedhore, si rishikimin e listës paraprake të zgjedhësve dhe procedurat përkatëse në rastet e korrigjimit të saj, si edhe afatet e parashikuara në ligj në lidhje me këto procedura. Gjithashtu, fletëpalosja i njohu zgjedhësit me aspekte të rëndësishme të procesit të votimit si dhe me të drejtën e ankimimit.

Krahas fletëpalosjes u përgatit edhe broshura pyetje-përgjigje "Kodi zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, tetor 2003". Ajo u vinte në ndihmë zgjedhësve, vëzhguesve dhe aktivistëve të KSHH-së, si dhe personave të tjerë të interesuar për të kuptuar më mirë rregullat ligjore të zgjedhjeve si dhe të drejtat e çdo zgjedhësi për të ushtruar lirisht të drejtën e zgjedhjes. Gjuha e përdorur në këtë publikim është një gjuhë e thjeshtë.

Fletëpalosja dhe broshura u shpërndanë tek zgjedhësit që votonin për herë të parë, zgjedhësit e moshuar dhe grupe të tjera të zgjedhësve nëpërmjet vëzhguesve të KSHH-së në rrethet ku ata vepruan.

VËZHGIMI I PROCESIT ZGJEDHOR

Vëzhguesit e KSHH-së për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, tetor 2003, kanë vëzhguar disa aspekte parazgjedhore, si: fushatën zgjedhore, shpalljen e listave paraprake, rishikimin e listave, ngritjen e KZQV-ve dhe të KQV-ve, trajnimin e komisionerëve etj. si dhe procesin zgjedhor gjatë ditës së votimit. Vëzhgimi i këtyre proceseve zgjedhore u shtri përkatësisht në Kukës, Gjirokastër, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Fier, Durrës dhe Tiranë.

KONFERENCA PËR SHTYP

Më 13 tetor 2003, KSHH-ja doli në një konferencë për shtyp me një raport paraprak ku u bënë të ditura disa nga përfundimet paraprake të vëzhgimit të zgjedhjeve të tetorit 2003, bazuar në raportet e vëzhguesve të KSHH-së. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të lartë të OSBE-së dhe të ODHIR-it në Tiranë, përfaqësues të Forumit të Vëzhguesve Vendorë si edhe përfaqësues të medias së shkruar dhe asaj elektronike shqiptare.

BASHKËPUNIMI I KSHH-SË ME ORGANIZATA VENDËSE DHE TË HUAJA

Gjatë procesit zgjedhor, KSHH-ja bashkërendoi punën e tij me atë të organizatave të tjera vëzhguese si edhe me organizmat ndërkombëtarë që veprojnë në Shqipëri, të cilët u aktivizuan në vëzhgimin e zgjedhjeve të tetorit 2003.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, më 26 shtator 2003, KSHH-ja, së bashku me disa organizata të tjera jofitimprurëse, nënshkroi një deklaratë, në të cilën shprehej angazhimi për respektimin e legjislacionit zgjedhor, paanësi, pavarësi politike, objektivitet, transparencë dhe përgjegjshmëri gjatë vëzhgimit të këtij procesi zgjedhor.

KSHH-ja i finalizoi këto veprimtari në kuadër të këtij projekti me këtë raport zyrtar përfundimtar për zgjedhjet e organeve për qeverisjen vendore të tetorit 2003.

Sh tojcë nr. 2

DEKLARATAT E KSHH-SË GJATË PROCESIT ZGJEDHOR, TETOR 2003

TRAJNIMI I ANËTARËVE TË KZQV-VE ËSHTË DETYRIM LIGJOR

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ndoqi me vëmëndje, deklaratën e datës 23 gusht 2003 të Z. Ilirjan Celibashi, kryetarit të KQZ-së, në të cilat nënvizon se në seminarët e organizuara për trajnimin e anëtarëve të KZQV-ve ka mungesa. KSHH-ja e konsideron të drejtë dhe shqetësues këtë deklaram. Lidhur me këtë, vlen të përmendet se në raportin përfundimtar që KSHH-ja ka përgatitur për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001, veç të tjerave nënvizonte se një nga defektet e vërtetuara, ishte dhe ai i trajnimit të vonuar, jo të plotë dhe jo cilësor të anëtarëve të komisioneve të zgjedhjeve. E keqja është se kjo dukuri, megjithëse në një masë më të reduktuar, po përsëritet edhe në këto zgjedhje.

Siç dihet, dispozitat e Kodit Zgjedhor i ngarkon Komisionet e Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore (KZQV-të) me detyrimin për verifikimin e dokumentacionit të kandidatëve për regjistrim, shpalljen paraprake të listave të zgjedhësve, shqyrtimin e kërkesave për ndryshime në këto lista, etj. Moszbatimi i detyrave të mësipërme mund të dëmtojë ecurinë normale të zgjedhjeve, si edhe të drejtat e shtetasve. Anëtarët e KZQV-së që pa arsye, ose për arsye të ndryshme i shmangen trajnimit, nuk mund të kryejnë detyrat që u ngarkon ligji.

Është kjo arsyeja që KSHH e shikon të nevojshme t'i sugjerojë Komisionit Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ-së), që në mbështetje të nenit 42 të Kodit Zgjedhor, të mos hezitojë për të vendosur sipas rastit, shkarkimin e atyre anëtarëve të KZQV-ve që nuk përmbushin detyrat e caktuara, duke i zëvendësuar ata me anëtarë të tjerë. Në sugjerimin e mësipërm, KSHH-ja ka parasysh faktet se KZQV-të krijohen sipas propozimeve të partive politike dhe se trajnimi i tyre është detyrim ligjor dhe përgjegjësi e KQZ-së.

Tiranë, më 25.08.2003

GABIMET E MUNDSHME NË LISTAT E ZGJEDHËSVE MUND TË KORRIGJOHEN

Fill pas shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve, në adresë të organeve kompetente po bëhen vërejte dhe kritika që kanë të bëjnë me mangësi në këto lista.

Pa paragjykuar aspak kritikën e mësipërme dhe as përgjegjësinë e mundshme të organeve përkatëse (gjë që duhet të vërtetohet), Komiteti Shqiptar i Helsinkit pas shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve si faktor decisiv në korrigjimin e tyre konsideron interesimin e vetë zgjedhësve. Njohja e tyre me listat e shpallura u jep mundësinë për të konstatuar nëse figurojnë ose jo në listë, nëse identiteti i tyre është ose jo i saktë.

Brenda afatit ligjor zgjedhësi ka të drejtë t'i drejtohet KZQV-së për korrigjimin e listës, madje kur është rasti të kundërshtojë vendimin e KZQV-së në gjykatë.

KSHH mendon gjithashtu se një kontribut të çmueshëm në korrigjimin e listave të shpallura mund të japin edhe subjektet zgjedhore të regjistruara në KQZ, që sipas kërkesës së tyre u vihen në dispozicion listat e zgjedhësve.

KSHH si një organizatë e specializuar dhe e angazhuar në fushën e të drejtave brënda mundësive të tij do të japë ndihmesën e vet modeste si në sensibilizimin e zgjedhësve për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes që u garanton Kushtetuta edhe në vëzhgimin e procesit të rishikimit të listave paraprake me synim, zbatimin e përpiktë të dispozitave të Kodit Zgjedhor si dhe udhëzimin përkatës të KQZ-së.

Tiranë, më 28.08.2003

TË MOS PENGOHET PROPAGANDA ZGJEDHORE

Në shtypin e djeshëm, u njoftua se mbështetësit e kandidatit të Partisë Demokratike Reformatore për Bashkinë e Durrësit, Ferdinand Xhaferri, në momentin kur ishin duke ngjitur postera të këtij kandidati u kërcënuan nga Krenar Koka, vëllai i kandidatit të PS-së, për kryetar të Bashkisë së Durrësit. Thuhet se për këtë është bërë edhe kallëzimi përkatës për ndjekje penale.

KSHH dhe pse nuk paragjykon zhvillimin e ngjarjes të pretenduar, fakt i cili do të sqarohet nga organet kompetente, e shikon të nevojshme të tërheqë vëmendjen për të drejtën që ka subjekti zgjedhor që të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme pa u penguar dhe pa u kërcënuar nga askush. Në këtë vështrim dhe në zbatim të nenit 135 të Kodit Zgjedhor, organet e qeverisjes vendore janë të detyruara të caktojnë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike.

KSHH sjell në vëmendjen e organeve të mësipërme faktin se në zgjedhjet e kaluara pikërisht për moszbatimin me korrektesë të kësaj dispozite, ka patur ankesa sidomos nga partitë e vogla.

KSHH ka parasysh se në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të këtij viti figurojnë të regjistruara si subjekte zgjedhore 50 parti politike. Të gjitha këto kanë të drejtë të zhvillojnë fushatën e tyre zgjedhore, ndërsa organet e qeverisjes vendore duhet t'i krijojnë atyre mundësinë e afishimit në vende të caktuara të materialeve të tyre propagandistike.

Me këtë rast i sugjerojmë KQZ-së që nëpërmjet strukturave të saj të ndjekë dhe të kontrollojë edhe zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me periudhën e fushatës zgjedhore.

Tiranë, më 15 shtator 2003

MË TEPËR PËRPJEKJE PËR KORRIGJIMIN E LISTAVE TË ZGJEDHËSVE

Në shtypin e përditshëm dhe në deklaratat e disa drejtuesve partiakë, jepen njoftime për pasaktësi të shumta në listat e zgjedhësve dhe sidomos për qindra, madje mijëra persona që nuk figurojnë në listat e shpallura.

KSHH nuk paragjykon as saktësinë dhe as gjerësinë e këtyre të dhënave. Megjithatë në një kohë kur mbeten edhe pak ditë nga përfundimi i afatit ligjor të verifikimit të listave paraprake, konsiderojmë të domosdoshme dhe urgjente shfrytëzimin e mundësive ligjore për korrigjimin e tyre.

KSHH mendon se vetë zgjedhësi i interesuar në ushtrimin e të drejtës së votës, duhet të njihet me këto lista dhe kur është e nevojshme, t'i drejtohet KZQV-së

përkatëse për korrigjimin e saj. Veç kësaj, sipas nenit 58 të Kodit Zgjedhor, të drejtën për të kërkuar ndryshime në listat paraprake, e kanë edhe partitë politike, subjektet zgjedhore dhe institucionet e tjera të interesuar.

Në këtë drejtim, KSHH vlerëson udhëzimet e KQZ-së lidhur me këtë çështje, si edhe nismën e programuar të tij për sensibilizimin e opinionit shoqëror nëpërmjet medias të shkruar dhe elektronike.

KSHH mendon se pavarësisht nga vështirësitë dhe mungesat e vërejtura, ekzistojnë mundësitë që listat e shpallura të plotësohen dhe të saktësohen me qëllim që zgjedhësit të jenë të sigurt se emri i tyre figuron në listën përkatëse të zgjedhësve.

Tiranë, më 17.09.2003

THIRRJE E KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT

Në 12 Tetor 2003 do të zhvillohen zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore. Kjo është një ngjarje e rëndësishme për të gjithë shoqërinë shqiptare që aspiron integrimin e saj në Evropë.

KSHH, organizata e parë joqeveritare dhe jopartiake e vendit tonë, anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, vëzhguese edhe në zgjedhjet e mëparshme, u bën thirrje të gjithë zgjedhësve, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, simpatitë apo përkatësitë partiake, që në 12 Tetor të ushtrojnë të drejtën e votës duke shprehur kështu vullnetin e tyre të lirë për alternativën që ata dëshirojnë.

KSHH, pjesëmarrjen në zgjedhje e konsideron element të rëndësishëm emancipues që shpreh pjekurinë e zgjedhjeve, si dhe preokupacionin e tyre në drejtim të konsolidimit të demokracisë, të rritjes dhe pjesëmarrjes së tyre në qeverisjen e vendit. Gjithë shoqëria shqiptare dhe partitë politike, si bartëse e opinionëve të veçanta në gjirin e kësaj shoqërie, janë tërësisht të interesuara për një pjesëmarrje sa më të gjerë në këto zgjedhje. Zhvillimi demokratik i Shqipërisë është në proces. Ai është sa i rëndësishëm, aq edhe kompleks. Zgjedhjet periodike parlamentare dhe ato të qeverisjes vendore, synojnë thellimin e mëtejshëm të këtij procesi për integrimin e vendit tonë në organizmat euro-atlantike. Organet që do të dalin nga zgjedhjet e 12 Tetorit të këtij viti në kushtet e decentralizimit dhe të autonomisë lokale, do të ndiejnë përgjegjësi më të madhe ndaj shtetasve të tyre.

KSHH u bën thirrje me këtë rast jo vetëm zgjedhësve, por edhe të gjitha forcave politike që të kontribuojnë në realizimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme, demokratike dhe të pakontestueshme.

KSHH u bën thirrje gjithashtu anëtarëve të KQV-ve, që në kryerjen e detyrës së tyre sa të rëndësishme, aq edhe delikate, autoritetin më të lartë të konsiderojnë ligjin.

KSHH shpreh bindjen se ditën e zgjedhjeve do të lihen mënjanë interesat e ngushta dhe pasionet partiake. Atmosfera e qetë do të ndikojë pozitivisht në shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.

Tiranë, më 10 tetor 2003

Sh tojcë nr. 3

KOMUNIKIMI ZYRTAR MES KSHH-SË DHE KQZ-SË

1. Shkelja e afatit për fillimin e fushatës zgjedhore (neni 103 i Kodit Zgjedhor) (2.09.2003).
2. Letër mbi Udhëzimet e KQZ në lidhje me për procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore (udhëzimet nr. 1, 2, 5) (12.09.2003).
3. Letër lidhur me udhëzimin Nr. 7, dt. 13.09.2003 të KQZ-së "Për emërimin e anëtarëve, Zv/Kryetarit dhe sekretarit të KQV-së, datë 18.09.2003.
4. Letër në lidhje me propagandën që kishte zhvilluar në fshatin Lefterehor të Delvinës, konsulli grek me qendër në Gjirokastrë (25.09.2003).
5. Letër në lidhje me moszbatimin e kriterëve të nenit 45 të KZ-së në lidhje me propozimet për anëtarë të KQV-ve në Elbasan (2.10.2003).
6. Letër mbi shkeljen e afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor në lidhje me propozimet e ardhura nga subjektet politike për anëtarët e KQV-ve në Shkodër, 3.10.2003.

Sh tojcë nr. 4

SHKURTESA

BE	Bashkimi Evropian
KKRT	Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KQV-	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
KSHH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
KZ	Kodi Zgjedhor
KZQV	Komisioni Zgjedhor për Qeverisjen Vendore
OSBE	Organizata e Sigurimit dhe Bashkëpunimit në Evropë
PD	Partia Demokratike
PDR	Partia Demokrate e Reformuar
PS	Partia Socialiste